



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 16 nëntor 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1611_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafin 1.1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Kapitullit VIII të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05_L-081
- Dispozitat e Nenit 18/4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nr. ZRRE/Li/Tr_06/17, dhënë KEDS,
- Kërkesës së KEDS për amendamentimin Kodit të Punës për Qasje në Toka dhe Ndërtesa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të datë 12.09.2022,

në seancën e mbajtur me datë 16.11.2022 nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET** Kodi i Punës për Qasje në Toka dhe Ndërtesa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, KEDS SH.A.

Arsyetim

- o Sipas Obligimeve të dhëna me Licencën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhënë KEDS SH.A, me datë 12.09.2022 KEDS ka dërguar në Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) Kodin e Punës për Qasje në Toka dhe Ndërtesa me propozim ndryshime në te.
 - o Plotësim/ndryshimet e tilla janë bërë në përputhje me dispozitat e Nenit 18/4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nr. ZRRE/Li/Tr_06/17, dhënë KEDS.
 - o ZRRE ka vlerësuar propozim ndryshimet e bëra nga KEDS, dhe pas analizimit të tyre, ato i ka përfshi në këtë Kod.
- II.** Obligohet KEDS që pas pranimit të këtij Vendimi, ta publikoj këtë Kod në faqen elektronike zyrtare të tij.
 - III.** Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
 - IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.




Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:


- KEDS
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Garib Bucaj, anëtar